

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligji nr. 03/1-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtarë me bashkëpunëtor profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të **Palës ankuese** :

J. B., Ul. Podgorica, Republika e Malit të Zi

Kundër:

Y. C./Q. R., e perfaqesuar nga B. Th.

Komuna e Gjakovës

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/204/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA28809), të datës 11 Qershor 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 29 Janar 2020 mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga J. B., kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013, të datës 11 Qershor 2013, për sa i përket kërkesës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA28809.**
- 2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/204/2013, i datës 11 qershor 2013, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numrin KPA28809.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 5 qershor 2007, J. B. (në tekstin e mëtejshëm: “pala ankuese”), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: “AKP”) ka kërkuar kthimin e posedimit të ngastrës kadastrale nr. ... në ... Pala Ankuese deklaroi prona ishte humbur si pasojë e konfliktit që ka ndodhur në vitin 1998/99 dhe si datë të humbjes kishte cekur 12 Qershor 1999. Ai kërkoi kthimin e posedimit të ngastrës e cila i është ndarë për nevoja të ndërtimit.
2. Së bashku me kërkesën ai nuk kishte dorëzuar në AKP, asnjë dokument që referohet te drejtave pronësore mbi pronën e kërkuar.

3. Në AKP, ai kishte dorëzuar dokumentet vijuese:
 - Letërnjoftim i lëshuar nga autoritetet e Gjakovës me 18 Janar 1993 ku shifet se vendbanimi i palës ankuese është fshati ...;
 - Një skicë të lokacionit ku ndodhet prona e kërkuar e vizatuar me dorë të lirë.
4. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë njoftimin e kërkesës më 13 Nëntor 2008 dhe 10 Qershor 2011. Prona e kërkuar ishte gjetur Shtëpi kulture e ndërtuar rishtazi.
5. B. Th. në Emër të Komunës së Gjakovës kishte refuzuar të nënshkruaj njoftimin për pjesëmarrje por kishte deklaruar se toka në të cilën është ndërtuar Shtëpia e Kulturës është e Komunës së Gjakovës
6. Në zyrat e AKP-së janë drejtuar Komunës së Gjakovës dhe njëjta në shkresën e datës 3 Mars 2009 me të cilën njoftoi AKP-në se Qendra e kulturës është ndërtuar në ngastrën ..., mbi bazën e këtyre dokumenteve:
 - Aktvendim i Asamblesë Komunale ..., i datës 28 Shtator 2007 me të cilin aprovohej plani rregullues urban i lagjes joformale "...".
 - Ekstrakt i planit urbanistik për ndërtimin e objektit të Qendrës së Kulturës
 - Leje ndërtimi për objektin e Qendrës
 - Fleta poseduese dhe kopja e planit të ngastrës ... ku shihej se prona është e evidentuar si shoqërore.
7. Sipas raportit të Verifikimit të datës 28 Tetor 2011, prona e kërkuar ishte gjetur e regjistruar në Kadastër në emër të palës përgjegjëse dhe asnjë evidencë nuk është gjetur që të ketë konfirmuar ndonjë të drejtë të palës ankuese mbi pronën e kërkuar.
8. Më 11 Qershor 2013, KKPK-ja me vendimin e saj KPCC/D/A/204/2013, (në tekstin e mëtejshëm: "Vendimi i KKPK-së", "Vendimi") e kishte refuzuar kërkesë për shkak të mungesës së dëshmive valide të prezantuara nga pala ankuese e as të gjetura nga AKP-ja. Arsyetimi i dhënë në paragrafin 35 të vendimit grupor gjen se në mungesë të provave kërkesa refuzohet.
9. Në versionin e vendimit individual në gjuhën serbe ka një mospërputhje gjuhësore ku thuhet se "*kërkesa hidhet*" ndërsa në versionin shqip dhe anglisht është korrekt "*kërkesa refuzohet*".
10. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës ankuese më 12 Maj 2016. Ai kishte paraqitur ankesë më 8 Qershor 2016.
11. Përfaqësuesi i Q. R. B. Th. e ka pranuar vendimin e Komisionit me 8 Nëntor 2013.

12. Me 30 Janar 2018 përfaqësuesi i Q. R. ka marr një kopje të ankesës por nuk ka evidence se në afatin e paraparë me ligj të jetë përgjigjur në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

13. Pala ankuese thekson se Komisioni kishte vendosur për lëndën e tij pa caktuar gjendjen faktike dhe duke zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Më tej ai thekson ka pas te drejtë shfrytëzimi dhe vendim ndarje por se komuna e Gjakovës duke e kërcënuar i ka zhdukur dokumentin dhe e ka marr truallin që ky e ka pas marr nga Komuna e para luftës. Pala ankuese as në fazën e ankesës nuk ka paraqitur asnjë provë në mbështetje të pretendimeve ankimore.

Arsyetimi ligjor

14. Gjykata Supreme, pasi shqyrtoi pretendimet në ankesë, vendimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, vlerëson se Vendimi KKKP-së, nuk është i përfshirë me asnjë gabim thelbësor apo zbatim të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe po ashtu nuk mbështetet në vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, prandaj, ankesa nuk mund të miratohet.
15. Neni 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, e parasheh që paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KKKP-ja, për ri posedimin e pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që e vërteton të drejtën pronësore mbi pronën e pa luajtshme private, por edhe që ai, apo ajo, nuk është në gjendje ta ushtrojë të drejtën e tillë pronësore për shkak të rrethanave të lidhura drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë në mes të 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999, apo rrethanave që rezultojnë nga ky konflikt.
16. Nuk kontestohet se pala ankuese fillimisht e kishte humbur posedimin mbi pronën e kërkuar për shkak të rrethanave që rezultojnë nga konfliktit i armatosur i viteve 1998/99, ashtu siç ka deklaruar, e po ashtu edhe sekretaria e AKP-së nuk kishte gjetur argumente për të kundërtën. Por pala ankuese nuk kishte paraqitur asnjë dokument me të cilin do të mbështete kërkesën e tij.
17. Megjithatë sipas verifikimit të Sekretarisë ekzekutive, pohimit të palës ankuese, palës përgjegjëse dhe provave të administruara si në vendimin e ankimuar, vërtetohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore e cila para konfliktit nuk dëshmohet se ishte e regjistruar në libra pronësor në emër të palës ankuese, por ishte e regjistruar në emër të komunës së Gjakovës. Kjo gjendje dëshmohet edhe në bazë të dokumenteve pronësore, fakte këto të cilat nuk i konteston as pala ankuese.
18. Në ushtrim të autoritetit të vet Komuna e Gjakovës kishte lejuar ndërtimin e shtëpisë rinore dhe për këtë solli dokumente dhe prova që dëshmojnë se prona ishte e komunës së Gjakovës.

19. Sipas dispozitave ligjore të cituara si më lartë, gjendjes së fakteve dhe dëshmive të administruara nga KKPK-ja, Gjykata Supreme gjen se pala ankuese nuk posedon dokument pronësie për konfirmimin e të drejtës pronësore në pronën kontestuese dhe me ankesë nuk paraqet prova të reja juridikisht të vlefshme, apo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje.
20. E drejta pronësore në pronë të pa luajtshme, ligjërisht nuk konstituohet vetëm për mes deklaratave të dëshmitarëve ashtu si vlerëson pala ankuese. Edhe po që se janë të qëndrueshme perëndimet se toka i është ndarë nga Komuna e Gjakovës për truall kjo nuk është e mjaftueshme po që se nuk dëshmohet se në atë truall është ndërtuar ndonjë objekt banimi.
21. Kjo për arsye të cakura në nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80) ku përcaktohet se, në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/L-154, Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në nenin 36 pika 1, e parasheh se “*Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri*”, ndërsa është evidente dhe e vërtetuar se në çështjen në shqyrtim nuk dëshmohet me asnjë provë relevante se ka ndodhur një punë juridike ligjore, lidhur me pronën kontestuese dhe se as që është evidentuar në regjistra publik.
22. Nga faktet e cekura si më lartë Gjykata Supreme vlerëson se, padyshim vërtetohet që KKPK, ka marrë vendim të drejtë dhe ligjor të bazuar në faktet dhe dëshmitë e vërtetuara ,kur gjen se kërkesa e palës ankuese nuk është përmbajtësore dhe nuk i përmbush kriteret e përcaktuara për tu shqyrtuar dhe vendosur lidhur me të, ashtu si parashihet në nenin 3.1, parag 3, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, andaj kërkesa si e tillë me të drejtë është refuzuar.
23. Gjykata gjatë shqyrtimit të kësaj lënde edhe *ex officio* gjen se, Vendimi individual në gjuhë serbe, që i referohej kërkesës së palës ankuese me numër KPA28809, KPCC/D/A/204/2013, i datës 11 Qershor 2013, ishte i përfshirë me gabim gjuhësor por që ky gabim nuk ndikon në përmbajtjen e çështjes së vendosur. Në vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se, “*kërkesa hedhet*”, kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe në vendimin individual në versionin në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se, “*kërkesa refuzohet*”.
24. Sipas dispozitave material përcaktohet se, në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur

me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, *“Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet versionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karshi versionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret”*.

25. Prandaj me që vendimi burimor grupor në të tria gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe, figuron se “refuzohet kërkesa”, nuk është me ndikim gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhë serbe, sepse duhet të jetë kërkesa refuzohet , e jo kërkesa hedhet, sepse interpretimi dhe versioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjinier dhe si i tillë përdoret.
26. Ky aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese apo palëve me interes ligjor, për të kërkuar të drejtën e tyre pronësore para gjykatës apo organit kompetent, nëse e vlerësojnë me interes legjitim.
27. Nga theksimet si më lartë, e në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore;

28. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSKKPA-A-073-2016, me datë 29 Janar 2020

Bashkp . Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani